



31736

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANË

NR. 31736

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Në Tiranë sot më dt. 09/06/2004 në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë unë gjyqtari Arisma Ceço mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Pertit KASAPI për regjistrimin e shoqërisë "RADIO SPORT" SH.P.K.:

K O N S T A T O V A S E:

Dokumentacioni i paraqitur Z. Pertit KASAPI, si ortak i vetëm për regjistrimin e SHP-së si person juridik për ushtrimin e aktivitetit:

- Me objekt eskuziv transmentimin e programeve Televizive dhe Radiofonike.

Kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992, DHE Nr. 7667, date 28.01.1993 "Për shoqëritë Tregtare";

V E N D O S A:

Të regjistroj SHPK "RADIO SPORT", si person juridik me kërkesën e Z. Petrit Kasapi, si ortak i vetëm, me kapital themeltar 500.000 lekë (pesëqindmijë) për të ushtruar veprimtarinë private:

- Me objekt eskuziv transmentimin e programeve Televizive dhe Radiofonike.

Shoqëria do ta ketë selinë në Lundër të Tiranës.

Administrator i shoqërisë do të jetë Elda Kasapi.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiraë.

GJYQTARI:

Arisma Ceço

A. Ceço



AKTI I THEMELIMIT

TE

SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
"RADIO SPORT " SHPK

Themeluesi i SHPK-së është:
I. Petrit Kasdapi, si person fizik Shqiptar, i biri i Ibrahimit, i datëlindjes 24
Janar 1957, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me pasaportë Nr. _____.

NENI 1

Themeluesi do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do
ta quajë " RADIO SPORT".

NENI 2

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në Lundër.
Me vendim të Asamblesë të Ortakëve mund të hapen seli sekondare, filjale,
apo forma të tjera shoërish, ashtu sikur do ta shikojë të nevojshme shoqëria,
brenda dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet me përjashtim të rasteve të
parashikuara në statut.

NENI 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
- Me objekt eskuziv transmentimin e programeve Televizive dhe
Radiofonike.

NENI 5

Kapitali thmeltar i shoqërisë do të jetë 500.000 lekë (pesëqindmijë) me
kontributin e ortakut të vetëm Petrit Kasapi, me kuotë pjesmarrëse prej 500.000
lekë.

STATUT

I

SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"RADIO SPORT" SH.P.K"



FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

NENI 1

Shoqëria private "RADIO SPORT" SHPK më poshtë e quajtur **SHOQËRI** formohet nga ortakut I vetëm i më poshtëm si themelues:

1. Petrit Kasdapi, si person fizik Shqiptar, i biri i Ibrahimit, i datëlindjes 24 Janar 1957, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me pasaportë Nr. _____.

NENI 2

SHOQËRIA formohet sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik shqiptar fillon me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar.

NENI 3

SHOQËRIA e ka selinë e saj në Tiranë, Lundër.

SHOQËRIA mund të ndryshojë selinë e saj, me miratim të ortakut.

NENI 4

SHOQËRIA e zhvillon aktivitein e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

SHOQËRIA mund të krijojë filiale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

NENI 5

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimit ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kuotën e kapitalit të futur në **SHOQËRI**, si dhe kompetencat që gëzon në marrjen e vendimeve të çdo karakteri të përcaktuara në këtë statut.

LIBRI I SHOQËRISË

NENI 6

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrdhëniet e punës, **SHOQËRIA** do të ketë librin e vet i cili do të quhet LIBRI I SHOQËRISË.

KONFIDENCIALITETI

NENI 7

Ortaku me personat e pranuar në *SHOQËRI* bie dakord të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon *SHOQËRIA*, kontratat që do të lidhi si edhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga *SHOQËRIA* dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet "SHPK", kapitalin themeltar dhe emrin e administratorit.

OBJEKTI

NENI 9

SHOQËRIA ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Me objekt eskuziv transmentimin e programeve Televizive dhe Radiofonike.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 10

SHOQËRIA do të zhvillojë aktivitetin e saj mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit kur mbaron përpara kësaj kohe, ose të zgjatjes së afatit të saj, sipas rregullave të përcaktuara më poshtë.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 11

Kapitali themeltar i *SHOQËRISË* është 500.000 lekë (Pesëqindmijë). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku. *SHOQËRIA* mund ta shtojë apo paksojë kapitalin e saj me miratimin të ortakut.

KONTRIBUTET

NENI 12

Kapitali themeltar i *SHOQËRISË* është i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm, i cili është pronar i një kuote pjesmarrëse prej 500.000 lekë (Pesëqindmijë)

PJESËT E KAPITALI THEMELTAR

NENI 13

Kapitali themeltar është i ndarë në 10 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë 50.000 lekë (Pesëdhjetëmijë) sejcila, të renditura sipas numërit të serisë 1 ÷ 10. Mbi bazën e kuotave të mësipërme, Petrit Kasapi disponon 100 % të pjesëve të kapitalit.

LËNIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TE KAPITALIT

NENI 14

Pjesët e kapitalit themeltar u transferohen të tretëve vetëm me miratim të ortakut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme në rrugë trashëgimnie.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 15

SHOQËRIA do ta konsiderojë qendrën e vet si SHOQERIA NENE, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filjalesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjithë ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ose jashtë saj.

NENI 16

Organi më i lartë i drejtimit të **SHOQËRISË** është Asamblea e Ortakëve, e cila mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme sipas ligjit. Asamblea thirret në mbledhjen e saj në të gjitha rastet që administratorët e gjejnë të nevojshme.

Ortaku lajmërohet me letër rekomande, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Në lajmërim njoftohet rendi i diës, përshkrimi i vendit, ditës dhe orës së mbledhjes.

Ortaku, mbas shqyrtimit të rendit të ditës së asamblesë e diskuton rendin e ditës dhe e miraton ose jo atë me shkrim.

Vendimet e Asamblesë duhet të mbahen në një proces-verbal, icili duhet të nëshkruhet dhe, në rastin e një Asambleje të jashtëzakonshme të bëhet në prani të një noteri.

ADMINISTRATORËT

NENI 17

SHOQËRIA përfaqësohet nga administratorët e saj, të cilët mund të jenë ortakut, ose jo. emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhet me vendim të Ortakut.

Administratorët, sipas rradhës së detyrave që cakton Asambleja e Ortaëve, do të kenë të drejtë të hapin llogari rrjedhëse në bankë në emër të **SHOQËRISË**, të lidhin kontrata me të tretët, të drejtojnë veprimtarinë e përditëshme, që lidhet me aktivitetin e **SHOQËRISË**, të përfaqësojnë **SHOQËRINË**, në mardhënie me organet e administratës shtetërore, gjyqësore dhe të tretët. Administratori është përgjegjës ndaj **SHOQËRISË**, ose ndaj të tretëve, qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit, ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

Administrator i **SHOQËRISË**, emrohet Elda Kasapi.

LIBRAT E SHOQËRISË, BILACI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 18

SHOQËRIA është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël, ose librave të tjerë edhe: LIBRIN E SHOQËRISË, në të cilin shënohen emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si edhe vendimet e Asamblesë

NENI 19

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti, ku i pari do të jetë 31 dhjetori i vitit 2004.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortakut, miratohen nga Asambleja.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 20

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, i cili përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna për fondin rezervë të domosdoshëm të përcaktuar nga ortakut, të fondeve të tjera që shihen të nevojshëm dhe, nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparëshme.

NENI 21

SHOQËRIA përfundon aktivitetin e saj në afatin e caktuar në këtë statut, me përjashtim të rasteve kur ky afat zgjatet me miratimin unanimit të ortakëve. Ajo

mund të shpërbëhet përpara afatit për arsye të parashikuara në ligj, si edhe kur veprimtaria konsiderohet nga Asamblea si e pa suksesëshme

NENI 22

SHOQËRIA hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të **SHOQËRISË**, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të likujdimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit Ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

NENI 23

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së **SHOQËRISË** ose gjatë periudhës së likujdimit, do të paraqiten gjykatës kompetente

NENI 24

Ky statut është hartuar në katër kopje.

ORTAKU I VETËM

Petrit Kasapi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
Nr. 5796 Rep.
Nr. _____ Kol.

VERTETIM

Sot më datë 8/6/2004, në Tiranë para meje noteres u paraqit personalisht Z. Petrit Kasapi, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti personale identifikuese, madhor dhe me zotësi për të vepruar i cili më deklaroi se sa më sipër është shkruar jashtë kësaj zyre, sipas vullnetit të tij të lirë dhe të plotë, nënshkruan rregullisht para meje dhe unë noterja pasi e gjeta atë konform ligjit, e vërtetoj.



NOTERE
Fatmara Shehu



31736

Z. A. Celo
09 QERSHOR 06.04

KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT

TIRANE

Unë i nënshkruari Petrit Kasapi, në bazë të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", kërkoj nga ana e juaj miratimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "RADIO SPORT", SHPK.

Objekti i kësaj shoqërie do të jetë:

- Transmetime radiofonike dhe TELEVIZIVE

Selia e shoqërisë do të jetë në Lundër të Tiranës.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 500.000 lekë.

Administrator i shoqërisë do të jetë Elda Kasapi.

KERKUESI

Petrit Kasapi

*Co requestant
06.06.04
Z. A. Celo*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
Nr. 0797 Rep.
Nr. Kol.

VERTETIM

Sot më datë 08/6/2004, në Tiranë para meje noteres u paraqit personalisht Z. Petrit Kasapi, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti personale identifikuese, madhor dhe me zotësi për të vepruar i cili më deklaroi se sa më sipër është shkruar jashtë kësaj zyre, sipas vullnetit të tij të lirë dhe të plotë, nënshkruan rregullisht para meje dhe unë noterja pasi e gjeta atë konform ligjit, e vërtetoj.

NOTERE
Fatmara Shehu

